
FREE TRADE IDEOLOGY OR PRACTICE OF LIBERAL ECONOMY, WITH SPECIAL EMPHASIS ON KOSOVO

Mustafe Kadriaj

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, mustafkadriaj@live.com

Burim Morina

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, bmorina7@hotmail.com

Ylber Krasniqi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, ykrasniqi@hotmail.com

Abstract: Kosovo is a country emerging from the economic practice of the socialist system where the whole economy was oriented and the party had the last word by dictating policies in production and trade, so demand was dictated by supply imposed by the state. Kosovo, unfortunately, faced the transition to a market economy and an unfair war, in addition to the casualties, there was considerable economic damage, but with the installation of the United Nations mission named UNMIK, the installation of the principles of market economy.

Apart from the trumpeting of the market economy by the UNMIK administration but also after the independence of the country, the market economy was just a formality starting from privatization and doing business where the last word was the oligarchy and informal groups installing and at the same time dictating economic monopolies and oligopolies from privatization where the vital economy, although privatized, still remained a monopoly, eventually an oligopoly, but at least competitive economies, at the same time the most powerful businesses in terms of capital operate according to the principle of oligopolies dictating price, a behavior contrary to free competition and most severely behind these businesses lie the people of politics making these businesses immune before the law resulting in distortion and damage to free trade.

It is natural that everyone wants cheaper, higher quality and more diverse products and services. No one is willing to pay more for something without any consideration. People are willing to pay more only when they perceive a benefit in quality. In general, everyone, perhaps except those who find it difficult to determine, want to have as many choices in front of them. This is only possible when there is more than one company in the market and they are in free competition with each other. Each company, trying to increase its profit on its own shall offer customers a combination of products or services that meet the requirements of cheap price, quality and various choices. One company may be more focused on lower quality but cheaper products, while the other company on the contrary; but in each case the competition between them results in a variety of offers and opportunities. Each consumer is then free to vote with their own money for or against the offers available. Because companies are completely at the mercy of the consumer — because without them they cannot generate revenue — they are forced to constantly respond to their wishes, and even to precede them. They are forced to take consumer votes seriously otherwise they face losses and eventually bankruptcy. This is essentially how the market economy works. On the other hand, when a product or service is not offered by the market but by a state-owned enterprise, price, quality and variety fall sharply. The state-owned enterprise does not act according to the dictates of the consumer because it is not dependent on their money.

Keywords: system, ideology, economic principles, monopoly, oligopoly, free competition

TREGTIA E LIRË IDEOLOGJI APO PRAKTIKË E EKONOMISË LIBERALE, ME THEKS TË VEQANT NË KOSOVË

Mustafë Kadriaj

Kolegji “BIZNESI” Prishtinë – Kosovë, mustafkadriaj@live.com

Burim Morina

Kolegji “BIZNESI” Prishtinë – Kosovë, bmorina7@hotmail.com

Ylber Krasniqi

Kolegji “Biznesi” Prishtinë – Kosovë, ykrasniqi@hotmail.com

Abstrakt: Kosova një vend i dalur nga praktika ekonomike e sistemit socialist ku i gjithë ekonomia ishte e orientuar dhe fjalën e fundit e kishte partia duke diktuar politika në prodhim dhe tregti pra kërkesa ishte e diktuar nga oferta që diktonte shteti. Kosova kalimin në ekonomi të tregut për fat jo të mirë u përball e me një luftë të drejtë përveç

viktimize në njerëz kishte dëme të konsiderueshme ekonomike por me instalimin e misonit të Kombëve të Bashkuara të emruar si UNMIK, në Kosovë filloi instalimi i parimve të ekonomisë së tregut. Përkundër trumbetimit për ekonomi të tregut si nga administrata e UNMIKU-ut por edhe mbas pavarësisë ekonomia e tregut ishte vetëm formalitet duke filluar nga privatizimi dhe të bërit biznes ku fjala e fundit ishte oligarkia dhe grupet jo formale duke instaluar njëherit duke diktuar monopolin dhe oligopolin ekonomik në vend, nga privatizimi ku ekonomia me vitale edhe pse u privatizua prap mbeti monopol eventalisht oligopol por mëse paku ekonomië konkurrese, njëherit bizneset më të fuqishme nga ana e kapitalit funksionojnë sipas parimit të oligopoleve duke diktuar çmimin, një sjellje në kundërshtim me konkurrencën e lirë dhe më e rënda prapa këtyre bizneseve qëndrojnë njerëzit e politikës duke u bërë që këto biznese të jenë imun para ligjit duke rezultuar me deformim dhe dëmtim të tregtisë së lirë.

Është e natyrshme që çdo kush dëshiron produkte dhe shërbime më të lira, më cilësore dhe më të llojllojshme. Askush nuk është i gatshëm të paguaj më shumë për diçka pa ndonjë kundërvlerë. Njerëzit janë të gatshëm të paguajnë më shumë vetëm kur e perceptojnë një përfitim në cilësi. Si dhe përgjithësisht, të gjithë, ndoshta me përjashtim të atyre që e kanë vështirë të përcaktohen, duan që para tyre të kenë sa më shumë zgjedhje. Kjo është e mundur vetëm kur në treg ekzistojnë më shumë se një kompani dhe ato janë në konkurrencë të lira me njëra-tjetrën. Secila kompani, duke tentuar në mënyrë vetjake që ta rris fitimin, detyrohet që t'i ofroj konsumatorëve një kombinim të produkteve apo shërbimeve që i përgjigjet kërkesave të çmimit të lirë, cilësisë dhe zgjedhjes së llojllojshme. Një kompani mund të jetë më shumë e përqendruar në produkte më pak cilësore por më të lira, ndërsa tjetra kompani në të kundërtën; mirëpo në secilin rast konkurrenca në mes tyre rezulton në llojshmëri të ofertave dhe mundësive. Secili konsumator është i lirë pastaj që të votojë me paratë e tij për apo kundër ofertave në dispozicion. Për shkak se kompanitë janë tërësisht nën mëshirën e konsumatorit—sepse pa të nuk mund të krijojnë të ardhura—ato janë të detyruara që vazhdimisht t'i përgjigjen dëshirave të tij, e madje edhe t'ju paraprijnë atyre. Ato janë të detyruara t'i marrin seriozisht votat e konsumatorit, ndryshe përballen me humbje dhe eventalisht falimentim. Kjo në esencë është si funksionon ekonomia e tregut. Në anën tjetër, kur një produkt apo shërbim nuk ofrohet nga tregu por nga një ndërmarrje shtetërore, çmimi, cilësia dhe llojshmëria pësojnë rënie të madhe. Ndërmarrja shtetërore nuk vepron sipas diktateve të konsumatorit sepse nuk është e varur nga paratë e tij.

Fjalët kyçe: Sistem, ideologji, parime ekonomike, monopol, oligopol, konkurrencë e lirë

1. DEFINIMI I EKONOMISË DHE TREGTISË

Ekonomi: është shkencë shoqërore që ka të bëjë me atë se si shoqëria në tërësi, prodhuesit dhe konsumatorët zgjidhin midis alternativave të ndryshme të mundshme të përdorimit të burimeve të rralla në procesin e prodhimit, shkëmbimit dhe konsumit të mallrave apo shërbimeve. (Skenderi, 2010, p. 65)

Biznes: është çdo lloj veprimtarie ekonomike, zakonisht private, që ka për qëllim fitimin. Në një mënyrë me biznes kuptohet edhe një ndërmarrje ose organizatë tjetër ekonomike. (Skenderi, 2010, p. 29)

Tregti: është shitja e produkteve që janë në formë të përfunduar, si radio, grurë, makina, etj. Këto mund të jenë blerë drejtpërdrejtë nga prodhuesit ose nga ofertues të tjerë. Tregtia është një koncept më i ngushtë se tregtimi. (Skenderi, 2010, p. 256)

Tregtimi: është një treg aktiv prej të cilit një vlerë e tregut (ose disa tregues të cilët mundësojnë kalkulimin e një vlere të tregut) është në dispozicion. (Skenderi, 2010, p. 256)

Veqantitë e tregtisë së lirë

Duke dhënë argumentet ekonomike dhe njerëzore pro tregtisë së lirë, Bjorn Lomborg arsyeton se bota duhet të ulë barrierat e tregtisë, ndërsa kapërcen disavantazhet e vogla që vijnë prej saj. Tregtia e lirë globale ofron mundësinë më të shkëlqyer për të përmirësuar mirëqenien njerëzore gjatë 15 viteve të ardhshme. Ka ndihmuar tashmë më shumë se një miliard njerëz të dalin nga varfëria gjatë çerekut të fundit të shekullit të kaluar. Ulja e barrierave tregtare edhe më tepër mund të dyfishojë të ardhurat mesatare të pjesëve më të varfra të botës gjatë 15 viteve të ardhshme. Po, tregtia e lirë ka kosto që duhen zgjidhur më mirë, por kostot janë gjerësisht të tejkaloeshme krahasuar me përfitimet. Megjithatë, në vende të pasura sot, humori i keq e ka penguar tregtinë e lirë. Kjo është një tragjedi. Askund nuk është kundërshtimi ndaj tregtisë së lirë më i lartë se në Shtetet e Bashkuara. Pavarësisht se kush e fiton garën presidenciale të muajit e ardhshëm, një skeptik i tregtisë së lirë do të ulet në Shtëpinë e Bardhë. Ndërkohë, protestat kundër marrëveshjeve të tregtisë së lirë po tërheqin mbështetje politike dhe turma në Gjermani, Belgjikë, Kanda, Suedi, Zelandë të Re, Australi dhe gjetkë. Më shumë sesa thjesht retorika ka ndryshuar. Një studim zbuloi se përdorimi i politikave proteksioniste u rrit me 50 për qind në 2015, duke e kaluar numrin e masave të liberalizimit të tregtisë në tre me një. Anëtarë të G20 – ekonomive më të përparuara dhe më të zhvilluara të botës, që përfaqësojnë më tepër se katër të pestën e PBB-së globale dhe tre të katërtën e tregtisë – ishin përgjegjës për 81% të masave ndëshkuese. Politikanët në vende të pasura bien pre e frikës së kuptueshme të publikut. Një marrëveshje tregtare krijon kosto përshtatjeje në zona të caktuara, si në SHBA-në e Perëndimit të Mesëm dhe Jugut, ku prodhimi mund të

jetë më i kushtueshëm dhe më pak efikas sesa jashtë shtetit. Përfitimet më të mëdha të tregtisë së lirë janë më pak të dukshme. Konsumatorët marrin një shumëllojshmëri mallrash me çmime më të lira. Tregtia i bën eksportet më të fuqishme, më efikase dhe më produktive. Përfitimet ndahen mes punëtorëve” Këshilltarët e Obamës për Këshillin Ekonomik zbuluan se mesatarisht industritë e eksportit i paguajnë punonjësit deri në 18% më shumë sesa firmat jo-eksportuese. Kundërshtimi ndaj tregtisë së lirë shpërfill realitetin tonë të ndërlidhur. Rreth 80% e tregtisë së lirë ndodh në zinxhira furnizimi të firmave transkombëtare, sipas një raporti të OKB për 2013. Ndërsa disa politikanë amerikanë bëjnë thirrje për tarifa kundrejt Meksikës, Byroja Kombëtare e Kërkimit Ekonomik vlerëson se rreth 40% e vlerës së importeve meksikane me SHBA-në përfitohet nga vetë kjo e fundit. Këto argumente janë të gjitha pjesë e arsytimit ekonomik pro tregtisë së lirë. Por argumenti më i fortë është moral. Analiza kosto-përfitim tregon se tregtia më e lirë është mënyra e vetme më e fuqishme për të ndihmuar qytetarët më të varfër të botës. Rigjallërimi i diskutimeve të tregëtisë së lirë globale, Raundit Doha të Zhvillimit i cili është lënë në harresë, do të sillte pakësim të numrit të njerëzve të varfër në një shifër 145 milionë në 15 vite, sipas kërkimit të komisionar nga Qendra e Kopenhagenit për Konsensus. Bota do të jetë 11 trilionë dollarë më e pasur çdo vit deri në 2030, ku 7 trilionë dollarë do t'i shkonin vendeve në zhvillim – e barasvlershme me 1000 dollarë personi për çdo vit në këto vende deri në 2030. Për më tepër, tregtia gjithashtu përmban përfitime më të mëdha për shoqërinë. Globalizimi ekonomik ka treguar se pakëson vdekshmërinë te fëmijët dhe shton jetëgjatësinë, për shkak të të ardhurave dhe informimit më të mirë. Në SHBA, tregtia në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar ka shtuar ndjeshëm jetëgjatësinë. Në Ugandë, tregtia më e lirë në 35 vitet e fundit ka treguar se e zgjat jetëgjatësinë me 2-3 vjet. Për më tepër, “tregtia e lirë i bën mirë mjedisit” për të cituar një studim akademik. Kjo mund të duket kundër intuitës. Por megjithëse çdo 10% e rritjes së prodhimit çdon në 2.5-5% më tepër ndotje, të ardhurat më të larta nga kjo bëjnë që teknologjia të përmirësohet dhe rregullat të bëhen më rrepta. Ky zbulim është mbështetur nga një studim që arriti në përfundimin se “tregtia priret të pakësojë tre masa të ndotjes së ajrit”. Njëkohësisht, tregtia e lirë ka treguar se krijon më shumë vende pune për gratë, pakëson diskriminimin në punë dhe përmirëson kushtet e të drejtave të njeriut. Sigurisht, jo çdokush përfiton nga tregtia më e lirë. Disa njerëz do të humbin vendin e punës dhe disa prej tyre do të kenë vështirësi të gjejnë punë tjetër. Por është e rëndësishme të krijohet një sens i përmasës së problemit. Një studim i fundit sugjeron se tregtia e lirë rrit pabarazinë e të ardhurave dhe kostoja e rishpërndarjes do të merrte 20% të përfitimeve. Kjo nënkupton se ne duhet të jemi të gatshëm të shpenzojmë ndoshta 20% të përfitimeve nga tregtia në ndihmë të atyre që humbin nga marrëveshjet tregtare, përmes trajnimeve për punë dhe ndihma të mirëqenies sociale për të përmirësuar rreziqet. Por gjithashtu tregon se 80% e përfitimeve – 9 trilionë dollarë – shkojnë për pakësimin e varfërisë, vdekshmërisë te fëmijët dhe ndotjes, për rritjen e jetëgjatësisë dhe uljen e diskriminimit të bazuar te gjinia dhe raca. Ndërsa kandidatët amerikanë për presidentë ka në përdorur retorikë proteksioniste, po të njëjtën gjë bëri dhe Obama kur ishte kandidat në 2008. Megjithatë ai u bë më pas një mbrojtës entuziast i marrëveshjeve të tregtisë së lirë, veçanërisht në mandatin e dytë. Tregtia, thotë ai, “ka ndihmuar ekonominë tonë më tepër nga sa e ka dëmtuar”. Teksa lë postin, ai e ka deklaruar këtë si një fushë “të punës së papërfunduar”. Po kështu duhet të jetë për të gjithë ne, nëse përqendrohemi më pak te frika dhe më shumë te faktet. (<https://www.reporter.al/mrekullia-e-tregtise-se-lire/>)

2. BARRIERAT NË TREGTINË E LIRË

Komisioni Evropian ka identifikuar katër fusha në të cilat Kosova duhet të shënojë progres të menjëhershëm me qëllim të fillimit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Njëra nga këto fusha është zhvillimi i tregtisë së lirë. Kosova në këtë fushë, sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike dhe shoqatave ekonomike, nuk qëndron keq, pasi që ka të nënshkruara marrëveshje për tregti të lirë me disa vende të rajonit si dhe është nënshkruese e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me vendet e Evropës Qendrore. Ata thonë se Kosova është shembull i mirë në respektimin e marrëveshjeve për tregti të lirë. Por, problemi sipas tyre, është në politikat jo të favorshme tregtare të Qeverisë së Kosovës për bizneset vendore. Drejtori i Institutit “Riinvest”, Lumir Abdixhiku thotë për Radion Evropa e Lirë se ka një ngulfatje të tregut nga institucionet e Kosovës. *Kosova është në rrugë të mbarë sa i përket marrëveshjeve për tregti të lirë, ne jemi shumë më tepër liberal dhe të lirë në relacion me vendet e rajonit. Por, tregtia e lirë nënkupton edhe ndërhyrjet institucionale në treg të Kosovës dhe jo vetëm relacionet e Kosovës me vendet tjera, dhe këto ndërhyrje kam përshtypjen se janë shumë të rënda”. “Kemi një ngulfatje të tregut nga prezenca e institucioneve në vend, kemi shumë barriera në treg dhe kemi një prezencë të madhe të informalitetit të evazionit dhe trajtim të pabarabartë të bizneseve në treg”.* Kosova është nënshkruese e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me vendet e Evropës Qendrore që nga viti 2007, nuk i ka ndihmuar Kosovës, pasi që vendi ka pasur problem me fuqinë e bizneseve, të cilat nuk ka arritur të konkurrojë në këtë treg të lirë. *“Natyrisht duhet theksuar që as CEFTA dhe as një marrëveshje e lirë tregtare nuk nënkupton që vendi të jetë duarkryq. Ka shumë hapësira që të mbrohen prodhuesit vendorë, sidomos ndaj produkteve të subvencionuar prej vendeve tjera”. “Tregtia e lirë nuk do të thotë që ne mund t'i lejojmë produktet e subvencionuar të konkurrojnë në Kosovë, por do të*

thotë që të krijojmë tregti të barabartë mes vendeve. Nëse një produkt i një shteti fqinj është i subvencionuar, nuk guxon të hyjë në Kosovë dhe të konkurrojë me një produkt kosovar”, thotë ai. Ndërkohë, ajo që do të ndihmonte në zhvillimin e tregtisë së lirë, sipas drejtorit ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikanë në Kosovë, Arian Zeka, është që produktet vendore të jenë në pozitë konkurruese me vendet me të cilat nënshkruhet marrëveshja për tregti të lirë. “Në këtë kontest është fjala për fuqizimin, për rritjen e kapaciteteve prodhuese për rritjen e potencialit eksportues të Kosovës dhe për gjenerimin e kapaciteteve të reja, pasi që aktualisht Kosova përballet me deficit të lartë tregtar”. “Realisht, Kosova nuk ka çka t’i importon këtyre vendeve më të cilat nënshkruan marrëveshje për tregti të lirë dhe në këtë kuptim, së paku për Kosovën, humb rëndësia apo efekti i nënshkrimit të marrëveshjeve për tregti të lirë”. Ndërmarrjet prodhuese të cilat kanë eksport në vendet e rajonit dhe dëshirojnë që të kenë treg edhe në vendet e Bashkimit Evropian, duhet të punojnë në përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe të punojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, arritja e nënshkrimit të marrëveshjeve për tregti të lirë dhe fuqizimi i këtij sektori do të kishte rëndësi të madhe në tërheqjen për investitorëve të huaj. Kosovës për zhvillimin e tregtisë së lirë duhet të ndihmojnë në krijimin e politikave ekonomike lehtësuese dhe më të favorshme në veçanti në sektorin e prodhimitarisë. “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore i cili do të mundësonte qarkullimin më të shpejt dhe më të lehtë të mallrave nga Kosova në vendet tjera është parakusht tjetër që të ndihmojë zhvillimin e tregtisë së lirë. Po ashtu edhe eliminimi i pengesave politike që mund të vinë nga shtete tjera që janë pjesë e marrëveshjes CEFTA”. (<https://www.evropaelire.org/a/24743711.html>)

3. PËRKUJDESJA NDAJ TREGTISË SË LIRË

Tregtia e lirë globale nuk është menyra natyrore e gjërave, ndaj do perkujdesje dhe të mirembahet. Sophus Reinert dhe Dante Roscini diskutojnë për tregtinë përgjatë kohërave dhe atë që na mëson historia.

Pyetje: Cilat modele dalin nga historia që mund të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë se ku jemi sot?. Sophus Reinert: Për shumë njerëz, globalizimi është teleologjik, diçka që domosdoshmërisht bëhet më e fortë në kohë dhe çon në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur ekonomikisht, por historia na thotë se kjo nuk është e vërtetë. Ka raste kur globalizimi merr një hap prapa. Nga viti 1850 deri më 1914 kishte një revolucion teknologjik: Me telegrafin, papritmas mund të komunikohesh nga Zelandia e Re në Londër për disa sekonda, dhe ftohja (frigoriferimi) mundësoi të kishte gjalpë të Zelandës së Re në Londër. Një shpërthim i tregtisë dhe rrjedhës së kapitalit krijoji një botë që dukej në shumë mënyra si e jona. Megjithatë, edhe në fillim të shekullit të 20-të, mbetën tensionet e rritjes së pabarazisë dhe konkurrencës së pagave në një kontekst të rivalitetit ndërkombëtar të pamëshirshëm. Në fund një e shtënë në Sarajevë vrau Kryepeshkopin Ferdinand dhe filloi Luftën e Parë Botërore dhe të gjitha u shembën. Si përqindje të PBB-së, ne nuk u kthyem në ato nivele të mëparshme të flukseve të kapitalit global deri në vitet 1990. Tregtia e lirë globale nuk është rendi natyror i gjërave. Globalizimi është një projekt, dhe projektet duhet të mbahen. Dante Roscini: Tregtia ka pasur peripecitë në histori, si me merkantilizmin – ideja se një shtet do të ishte më mirë duke e bërë shtetin fqinj më të varfër – e cila mbizotëronte në Evropë për shekuj me radhë dhe çoi në shumë luftëra. Globalizimi u rrit në fillim të viteve 1900 deri në Depresionin e Madh, kur pamë vende të mbyllën për veten e tyre. Akti tarifor i mbrojtjes Smoot-Hawley i vitit 1930 shpuri në hakmarrje në të gjithë botën dhe tregtia kaloi në një spirale rënëse që përkeqësoi krizën. “Një gjë që ne rimësojmë, është se fitimet nga tregtia nuk do të thonë se domosdoshmërisht të gjithë fitojnë”. Pas Luftës së Dytë Botërore, bota kërkonte një zgjidhje për mungesën e institucioneve multilaterale për të qeverisur tregtinë duke krijuar Marrëveshjen e Përgjithshme të Taksave dhe Tregtisë – e cila më vonë u bë OBT.

Reinert: Një gjë që ne vazhdojmë të rimësojmë është se fitimet nga tregtia nuk do të thotë që të gjithë fitojnë. Është e qartë se tregtia globale gjatë dekadave të fundit ka gjeneruar më shumë pasuri sesa çdo periudhë e mëparshme në historinë njerëzore. Por nëse shikoni, në përqindje, se sa nga ajo ka shkuar në klasën e mesme të re në Azi, Indi dhe Kinë – dhe jo në klasën e mesme të punës në botën e zhvilluar – këtu e sheh revoltën. Duke pasur parasysh rëndësinë e stabilitetit të projektit të globalizimit, mund të na duhet të shqyrtojmë sërish pasojat politike të shpërndarjes.

Roscini: Nuk ka dyshim se ka një fitim të përgjithshëm. Por pyetja është, kush fiton? Kush humbet? Interesat e përqendruara që ndikohen negativisht nga tregtia e lirë në disa industri apo rajone, çojnë në kërkesa për mbrojtje nëpërmjet barrierave tregtare. Politikanët i shohin këto kërkesa dhe më pas ne jemi dëshmitarë të tregëtisë periodike. Lufta e Catfish-it është një shembull i famshëm që hedh poshtë Misisipi Delta, ku shumë njerëz të varfër jetojnë jashtë industrisë së Catfish-it, kundër Mekong Delta, ku ke të njëjtën gjë. Prodhuesit amerikanë mendonin se po kërcënoheshin nga peshq të lirë nga Vietnam dhe politikanët vendës dolën deri në Washington, gjë që imponoi një sërë barrierash tregtare. Shpenzimet mbulohen nga interesa të shpërndara, duke përfshirë edhe konsumatorin, i cili përfundon duke paguar çmime më të larta.

Zakonisht si janë zgjidhur konfliktet tregtare dhe pse është kaq e vështirë për të arritur atje?

Reinert: Një pjesë e madhe e punës sime është në periudhat e mëhershme, kur luftërat tregtare ishin fjalë për fjalë luftëra – kur anglezët donin të dominonin hollandezët dhe ata vepruan. Ne nuk jemi në atë botë më, por është një kujtesë e dobishme se sa të larta mund të jenë rreziqet.

Roscini: Normalisht palët arrijnë një marrëveshje, idealisht nën patronazhin dhe sipas rregullat e OBT-së. Problemi është se në ditët e sotme luftërat tregtare mund të kenë pasoja të paqëllimshme që e komplikojnë zgjidhjen e tyre. Zinxhirët e furnizimit global janë tepër komplekse. Kur një telefon dizajnohet në Amerikë dhe bashkohet si produkt në Kinë me furnizime nga 30 vende të tjera, nga cili vend është produkti final?

“Përpyekja për menaxhim të flukset tregtare në çdo produkt specifik përmes tarifave ose barrierave, prek shumë elementë të tjerë me efekte që janë të vështira për t’u parashikuar.

Reinert: Për mijëvjeçarë, shumica e tregtisë ishte ose në lëndë të parë ose në mallra të gatshme. Deri kohët e fundit, një tarifë për makinat ishte për të ndaluar importin e makinave të përfunduara. Por sot, shumë tregti ka të bëjë me mallra të ndërmjetme që mund të shkëmbehen përtej kufijve. Pra, edhe politika e të kuptuarit të tarifave, qëllimeve dhe pasojave të tyre, është shumë më e errët. Ajo kërkon një lloj shumë të ndryshëm angazhimi, me atë që dikur ishte një mjet mjaft i hapur. Që ne jetojmë në një botë të shteteve të pavarura politikisht por ende të ndërvarura ekonomikisht, dihej që në kohën e Adam Smith. Për sa kohë që jetojmë në atë botë, do të detyrohemi të përballojmë këto sfida. Nuk mund të rrimë dhe të presim një ekonomi botërore gjithnjë në rritje, më të pasur dhe më paqësore. Një sistem ndërkombëtar duhet të rritet. Ne nuk duhet ta nënvleresojmë këtë të fundit – kjo është ajo cka kemi mësuar.

(<https://expocity.al/SQ/zhvillimi-i-nevojave-te-tregtise-se-lire-dhe-mesime-te-tjera-nga-historia/#.X8QJZs1KJIU>)

4. PRAKTIKA TË KEQPËRDORIMIT TË TRETISË SË LIRËS NË KOSOVË

Ka një kohë, që janë pothuajse të njëjta çmimet e derivateve në HIB Petrol, Al Petrol e Exfis, kompanitë më të mëdha që merren me shitjen e derivateve të naftës në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Çmimi nuk ju dallon shumë as në shitjen e derivateve Unleaded 100 RON Power, Euro Super 95, Euro Diesel 10 PPM, Euro Diesel 10 PPM Power. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, rregullon marrëveshjet e ndaluara apo praktikatat e bashkërenduara. Më këtë çështje, sipas ekonomistit, Mustafë Kadriaj, do të duhej të merrej Ministria e Tregtisë. Ai e quan të “zakonshëm” dakordimin për çmime në mënyrë jo formale.



ndonjë përgjigje as në formë elektronike.

“Oligopoli ekonomik ku bizneset merren vesh për harmonizim të çmimit me marrëveshje zakonisht jo formale. Që në këtë rast Ministria e Tregtisë duhet të thotë fjalën e vet përmes inspektorëve relevant. Jo për faktin që ekonomia e Kosovës vepron sipas konkurrencës së plot. Së paku sipas ligjeve ne fuqi”, deklaroi Kadriaj.

Në Ministrinë e Tregtisë, konkretisht në Inspektoratin e Tregut nuk kanë dhënë një përgjigje në lidhje me këtë, pavarësisht interesimit të portalit. “Kryeinspektori është në terren”, janë përgjigjet e tyre për disa herë radhazi sa i ka telefonuar portali arbresh.info, duke mos kthyer



pas diferencim 1 deri 2 cent tani kemi diferencim më të lartë. Qytetarët kanë mundësi të bëjnë përzgjedhjen”. 14

E ata që merren me monitorimin e këtyre çmimeve, kanë bërë të ditur se pikërisht për këto çështje ata janë ende në gjykatë me kompani të ndryshme.

Valon Prestreshi nga Autoriteti i Konkurrencës, duke folur për këtë çështje është shprehur i bindur se do të fitojnë rastin me kompanitë e dënuara.

“Momentin që kemi zëvendësueshmëri dhe mundet qytetari ta bëjë përzgjedhjen, atëherë jemi në nivelin e konkurrencës në momentin që të gjitha pompat e kanë njëjtë atëherë lind dyshimi dhe problemi, se s’ju lejon qytetarëve të bëjnë diferencimin. Para vendimit të Autoritetit kemi

kompani u dënuan në maj të këtij viti me mbi katër milionë euro, për çrregullim të konkurrencës në treg gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018.



Kompanitë që pothuajse edhe tani kanë çmime të ngjashme janë në mesin e kompanive të dënuara në maj të këtij viti.

EXFIS u dënuan me 537,899 euro, Al Petrol u dënuan me 989,493 euro dhe HIB Petrol u dënuan me 1,108,988 euro.

Hetimi lidhur me këtë rast kishte filluar në fillim të vitit 2019, kur ishin ngritur dyshimet se operatorët e shitjes me pakicë të derivateve të naftës nuk kishin reflektuar në mënyrë individuale me rastin e caktimit të çmimeve gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018.

(<https://ekonomiaonline.com/tag/mustafekadriaj/>)

5. PËRFUNDME DHE REKOMANDIME

Ekonomitë e tregut në mbarë botën ndajnë disa karakteristika kryesore. Për shembull, shumica e mallrave dhe shërbimeve janë në pronësi private. Kështu, pronarët e bizneseve mund ta shesin biznesin e tyre për fitim. Pronësia është e vlefshme në një ekonomi tregu. Njerëzit që jetojnë në këtë lloj ekonomie mund të blejnë çdo produkt që dëshirojnë për sa kohë që ata janë në gjendje ta përballojnë atë. Kjo kërkon para, e cila bëhet çelësi i këtij lloji të shoqërisë. Për të fituar para, individët duhet të shesin diçka. Në këtë rast, shitja e kohës së tyre për punëdhënësit është mënyra më e zakonshme për të fituar para. Mallrat u shpërndahen individëve me më shumë para. Interesi vetjak motivon veprimet, furnizuesit shesin me çmimin më të lartë të mundshëm dhe konsumatorët negociojnë çmimin më të ulët të mundshëm. Ky interes vetjak siguron një reflektim të saktë të ofertës dhe kërkesës, e cila ndihmon në kontrollin e çmimeve. Përveç kësaj, fokusi i furnizuesve në ekonomitë e tregut është në rritjen e fitimit dhe jo në sigurimin e përmbushjes së nevojave bazë të publikut.

Përparësitë - Ashtu si me të gjitha kornizat ekonomike, ekonomitë e tregut kanë një numër përparësish. Një nga avantazhet më të mëdha është se konkurrenca nxit efikasitetin. Kjo do të thotë që për të qenë i suksesshëm, prodhuesit duhet të shqyrtojnë me kujdes proceset e tyre të prodhimit, të zvogëlojnë shpenzimet dhe të reduktojnë kohën e prodhimit. Përveç që të jetë efikas, furnizuesit duhet të jenë gjithashtu krijues dhe inovativ për të mbajtur një avantazh konkurrues. Ky mjedis gjithashtu çon në diversitetin e mallrave në treg, të cilat u japin konsumatorëve më shumë zgjedhje. Këto zgjedhje promovojnë idenë e lirisë së zgjedhjes, edhe pse zgjedhja varet nga paratë e disponueshme.

Disavantazhet - Një nga disavantazhet më të mëdha të ekonomive të tregut është mbështetja e tyre në para si masë primare dhe mjete të suksesit. Kjo krijon një shoqëri të individëve të pasur kundrejt atyre të varfër. Hendeku midis këtyre dy grupeve vazhdon të zgjerohet, sepse në këtë ekonomi është më e lehtë për njerëzit me para që të bëjnë më shumë para, duke përjashtuar njerëzit që jetojnë në varfëri nga lëvizshmëria lart. Për shkak se fokusi është në fitimin, furnizuesit synojnë të ulin kostot e prodhimit të cilat mund të çojnë në dëmtime mjedisore. Shpesh është më e shtrenjtë të prodhohen mallra në mënyrë ekologjike të qëndrueshme, prandaj kërkohet rregullore të qeverisë. Objektivi kryesor i ekonomive të tregut është fitimi, jo përmbushja e nevojave sociale. Si rezultat, programet si sigurimi social, asistenca ushqimore, ndihma mjekësore dhe përfitimet e papunësisë kanë tendencë të jenë më të vogla dhe mbështeten në taksat për financim. Kjo do të thotë që individët me disavantazhe nuk janë në gjendje të konkurrojnë në treg.

Rekomandime - Promovimi i mëtejme i integritit të Kosovës në ekonominë botërore dhe fuqizimi i rolit të shtetit në qeverisjen ekonomike përmes funksioneve efektive rregullatore në përputhje me detyrimet e MSA-së. Mbështetja e Qeverisë së Kosovës në zhvillimin e mëtejme të kapacitetit institucional për të krijuar bazën për një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit privat në përputhje me kërkesat të BE-së dhe të MSA-së. Rritja e kapacitetit të Qeverisë së Kosovës për të zhvilluar, negociuar dhe zbatuar politikën tregtare, përfshi mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale, në pajtim me kërkesat e tregtisë ndërkombëtare dhe praktikat e BE-së dhe përmirësimi i kapacitetit të Qeverisë për të mbështetur tregtarët eksportues/importues.

REFERENCAT

Ceku & Rashidi, B. (n.d.). Marketingu. Prishtinë.

Çela, H. (2003). Etika dhe Biznesi. Tiranë: SH.B Botimet Morava.

- Duka, A. X. (1999). Sjellja Konsumatore. Tiranë: Shtëpia Botuese Librit Universitar.
- Elmazi, L. (2002). Strategjia Marketing. Tiranë: SH.B Libri Universitar.
- Epping, R. C. (2007). Një Guidë e Ekonomisë Botërore. Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit.
- Kume, V. (2000). Menaxhimi Stratgjik. Tiranë: SH.B. PEGI.
- Livoreka, R. (2011). Kërkim Marketingu. Prishtinë: Dinograf.
- Manxhari, M. (2010). Sjellja në Organizatë, Kuptimi dhe Menaxhimi i Aspektit Njerëzor të Organizatës. Tiranë: SH.B Onufri.
- Blakeslee, R. & Garcia, A. M. (2002). Gjuha e Tregtisë. Tiranë: Zyra e programeve ndërkombëtare të informacionit - Departamenti i Shtetit i SHBA-ve .
- Rexha & Reshidi, N. (1998). Bazat e Marketingut. Prishtinë: Riinvest.
- Segetlija, Z. (2009). Afarizmi Tregtar. Prishtina: Universiteti "Victory", Prishtinë.
- Skenderi, N. (2010). Fjalor Ekonomiko-Social. Prishtinë: Aleanca Kosovare e Bizneseve.
- Tracy, B. (2013). Motivimi. Prishtinë: SH.B Botimet Damo.
- Vukmir, B. (2007). Strategjia dhe taktika e negociimit. Prishtinë: Kolegji Universitar "Victory".
- Yunus, M. (2013). Ndërtimi i Biznesit Social. Tiranë: UET Press.
- <https://expocity.al/SQ/zhvillimi-i-nevojave-te-tregtise-se-lire-dhe-mesime-te-tjera-nga-historia/#.X8QJZs1KjIU>. (n.d.).
- <https://kosovoprojects.eu/sq/project/mbeshtetje-e-metejshme-per-zhvillimin-e-tregtise-ne-kosove/>. (n.d.).
- <https://www.evropaelire.org/a/24743711.html>. (n.d.).
- <https://www.reporter.al/mrekullia-e-tregtise-se-lire/>. (n.d.).